

**VENDIM**  
**Nr.478, datë 23.6.2005**

**PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË DISA NDËRMARRJEVE**  
**PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të viti 2005”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 308 800 000 (treqind e tetë milionë e tetëqind mijë) lekësh, i cili të përdoret si më poshtë vijon:

a) 201 097 000 (dyqind e një milion e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj KESH sh.a.-së, nga:

- Kombinati Energjetik, Elbasan, 131 935 000 (njëqind e tridhjetë e një milion e nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë,

- Albkrom, sh.a.-ja, 69 162 000 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë ) lekë.

b) 107 703 000 (njëqind milionë e shtatëqind e tre mijë) lekë, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, nga Albakër, sh.a., ndaj:

- KESH sh.a.-së, 43 000 000 (dyzet e tre milionë) lekë,

- Institutit të Sigurimeve Shoqërore, 64 703 000 (gjashtëdhjetë e katër milionë e shtatëqind e tre mijë) lekë.

KESH sh.a.-ja, shumën prej 43 000 000 (dyzet e tre milionë) lekësh, ta përdorë për të shlyer detyrimet e prapambetura ndaj Armo, sh.a.-së, dhe Armo sh.a.-ja, të njëjtën shumë, ta përdorë për të shlyer detyrimet e prapambetura ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

2.Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 91 200 000 (nëntëdhjetë e një milion e dyqind mijë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve të ujësjellësve ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Këto fonde të përballohen nga fondi i kontingjencës, i planifikuar për vitin 2005.

4. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

LISTA E SHA UJËSJELLËS- KANALIZIME DEBITORE NDAJ INSTITUTIT TË SIGURIMEVE  
SHOQËRORE

| Nr. | Emërtimi                                 | Shuma e detyrimeve |
|-----|------------------------------------------|--------------------|
| 1   | Sh.a. ujësjellës- kanalizime Fushë Krujë | 2170               |
| 2   | Sh.a. ujësjellës Rrogozhinë              | 611                |
| 3   | Sh.a. ujësjellës- kanalizime Fier        | 2805               |
| 4   | Sh.a. ujësjellësi Patos                  | 10 000             |
| 5   | Sh.a. ujësjellësi Ballsh                 | 10 000             |
| 6   | Sh.a. ujësjellësi Novoselë               | 1684               |
| 7   | Sh.a. ujësjellësi Korçë Fshat            | 1969               |
| 8   | Sh.a. ujësjellësi Peqin                  | 4000               |
| 9   | Sh.a. ujësjellësi Elbasan Fshat          | 5000               |
| 10  | Sh.a. ujësjellësi Berat                  | 5000               |
| 11  | Sh.a. ujësjellësi Kuçovë                 | 5000               |
| 12  | Sh.a. ujësjellësi Poliçan                | 5000               |
| 13  | Sh.a. ujësjellësi Lushnjë Fshat          | 5000               |
| 14  | Sh.a. ujësjellës- kanalizime Lezhë       | 5000               |
| 15  | Sh.a. ujësjellësi Vau i Dejës            | 333                |
| 16  | Sh.a. ujësjellësi Bulqizë                | 2322               |
| 17  | Sh.a. ujësjellësi Krastë                 | 2827               |
| 18  | Sh.a. ujësjellësi Laç                    | 3231               |
| 19  | Sh.a. ujësjellësi Gjirokastrë Fshat      | 2766               |
| 20  | Sh.a. ujësjellësi Gjirokastrë Qytet      | 2666               |
| 21  | Sh.a. ujësjellësi Libohovë               | 761                |
| 22  | Sh.a. ujësjellësi Mat                    | 1055               |
| 23  | Sh.a. ujësjellësi Shkodër Qytet          | 10 000             |
| 24  | Sh.a. ujësjellësi Rrëshen                | 2000               |
|     | <b>Shuma</b>                             | <b>91 200</b>      |